

Monitorimi

... monitorimi i performancës do të thotë

Llogaridhënie Publike

Qëllimi i monitorimit ka kaluar nga kontrolli i bashkëpunimit të ministrisë në sigurimin e përmbushjes së objektivave të performancës nga ana e qeverisë. Çdo vit, Departamenti i Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndhmës së Huaj (DEBASKON) përgatit Raportin Vjetor të Progresit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI). Ky raport paraqet progresin vit pas viti në bazë të 44 treguesve strategjikë të nivelit të lartë.

Të monitorosh do të thotë t'i zgjidhësh problemet paraprakisht. DEBASKON-i, Ministria e Financave dhe Ministria e Integritimit Evropian monitorojnë rregullisht performancën e ministrive për të identifikuar problemet e mundshme. Më pas, institucionet qendrore punojnë me ministrinë për të hartuar masat ndreqëse dhe për të sjellë në vëmendjen e ministrave çështje të rëndësishme përpara se ato të shndërrohen në probleme madhore.

Një mekanizëm i ri monitorimi i bazuar në performancën e strategjive sektoriale dhe ndër-sektoriale u iniciua nga DEBASKON dhe u implementua për herë të parë në vitin 2010. Ky mekanizëm është pjesë e proceseve të SPI-së, dhe si rrjedhojë ai monitoron performancën në nivel rezultatesh të objektivave politike, duke mbështetur në të njëjtën kohë planifikimin e rezultateve SMART.

Qëllimi i këtij mekanizmi është :

Të përmirsojë performancën e treguesve dhe të vlerësojë arritjet e objektivave politike – lidhur me implementimin e SKZHI-së dhe strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale, nëpërmjet përmirësimit të treguesve të monitorimit.

Të mbështesë planifikimin kombëtar dhe performancën e buxhetit – si pjesë integrale e SPI-së, duke bërë shfytëzim më të mirë të informacionit strategjik të disponueshëm nëpërmjet deklaratave të programit politik të përfshirë në PBA, sektor I ministrive.

Të ndimojë ministrinë e linjës në analizën e politikave të programit të tyre – duke përmirësuar implementimin e strategjive të tyre sektoriale nëpërmjet shqyrtimit të politikave të programit dhe duke përfshirë të rejtat nga procesi I monitorimit.

Të promovojë përgjegjësinë dhe të rrisë transparencën – duke i mundësuar KPS-së të bëjë një analizë të thellë të nivelit në të cilin ministrinë kanë arritur objektivat e tyre politike dhe të vendosin lidhur me masat që duhet të ndërmerren për të bërë implementimin e tyre.

Të përgatisë bazat për rishikimin e Strategjisë Ndërkombëtare për Zhvillim dhe Integrim – duke përdorur objektivat dhe treguesit e raporteve të monitorimit, të cilat reflektojnë shkallën në të cilën po implementohen prioritetet politike të Qeverisë, të përfshira në dokumentin e SKZHI- së.

Monitorimi është vetëm fillimi i partneriteteve të reja. Në vitin 2009, DEBASKON-i, Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë testuan mënyrat se si vlerësimet e impaktit mund të përdoren si një instrument qendror i politikave të sistemit vendimmarrës të qeverisë. Duke identifikuar alternativat politike dhe politikën përkatëse, ndikimet fiskale dhe rregulluese, ministrinë do të konsultohen dhe do të angazhojnë gjerësisht palët e interesuara në hartimin e politikave të reja. Mënyra krijuese për të mbledhur ide dhe këndvështrime duke përdorur internetin do t'u shtohen takimeve tradicionale ballë për ballë si një mekanizëm këshillimi.

Raporti i parë i Monitorimit të SKZHI-së u paraqit në vitin 2008.

Zbatimi i SPI mbështetet nga një Fond Besimi në shumën \$7.9 milion, i menaxhuar nga Banka Botërore dhe me pjesëmarrjen e 7 donatorëve: Britania e Madhe, BE, Austria, Holanda, Italia, Suedia, dhe Zvicra.

Grupi Mbështetës i SPI-së (me përfaqësues nga qeveria dhe donatorët) mbledhet rregullisht sipas funksionit të tij mbikëqyrës për zbatimin e SPI-së.

Elementet përbërëse të fondit të Besimit të SPI-së që mbështet monitorimin janë në proces finalizimi.